| | | | 98 (3) | njoftimi të anullimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.<br><br>Në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, në procedurat e prokurimit me faza, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/ entit kontraktor:<br>a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim, në procedurat e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 98 (4) | prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;<br>b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.<br><br>Në rastin e ankesave për lidhjen e një kontrate në bazë të një marrëveshjeje kuadër, me disa operatorë ekonomikë, pas procedurave për rihapjen e konkurimit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Afate për ankime të veçanta 99 (1) | autoritetit/entit kontraktor:<br>a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;<br>b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 99 (2) | Në rastin e procedurave me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit. Nëse është publikuar njoftimi vullnetar për transparencë, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, sa i takon plotësimit të kushteve për përdorimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe përmbajtjes së | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dokumentave të tenderit.<br><br>Në rastin e konstatimit të një kontrate publike të lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në këtë ligj dhe/ose në rastin kur nuk është publikuar njoftimi i fituesit ose njoftimi i kontratës së nënshkruar, afati për paraqitjen e një ankese lidhur me këtë kontratë është 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga dita e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. | | |
| | | | **4. Projektligj**<br><br>(32) | Në nenin 110 ”Afatet për ankim”, pikat 2, 3 dhe 6 ndryshojnë si më poshtë, si dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | shtohet pika 9 dhe 10:<br>”2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose njoftimi paraprak i vendimit të anulimit.<br>Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”.<br>3. Në procedurat e prokurimit me faza mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve për fazën e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | parakualifikimit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim. Në procedurat e prokurimit me faza nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit të ofertave pas fazës së parakualifikimit operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen sipas përcaktimeve në pikën 2 të këtij neni.<br>6. Në rastin e ankesave për konstatimin e një kontrate të pavlefshme sipas parashikimeve të nenit 119 të këtij ligjit, afati për | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | paraqitjen e një ankese lidhur me këtë kontratë është 60 ditë nga dita e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës”.<br>9. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.<br><br>10.Sistemi i Prokurimit Elektronik njofton operatorët ekonomikë në mënyrë automatike për datën e fillimit dhe të përfundimit të afateve të ankimit. | | |
| Pavlefshmëria 2d (1) | Shtetet anëtare garantojnë që një kontratë | | **1. Ligji 162/2020 “Për** | Një kontratë do të konsiderohet e | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | konsiderohet e pavlefshme nga organi shqyrtues i pavarur nga autoriteti kontraktor ose që pavlefshmëria e saj është rezultat i vendimit të këtij organi shqyrtues në një nga rastet e mëposhtme:<br><br>a. kur autoriteti kontraktor ka dhënë një kontratë pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, kur kjo nuk është e lejueshme në përputhje me Direktivën 2014/25/BE ose Direktivën 2014/23/BE;<br><br>b. në rastin e shkeljes së nenit 1, paragrafi 5; nenit 2, paragrafi 3; ose nenit 2a, paragrafi 2, të kësaj Direktive, kur kjo shkelje e ka privuar ofertuesin që aplikon për shqyrtim, nga mundësia për të kërkuar korrigjime | | **prokurimin publik"**<br><br>Pavlefshmëria e kontratës 119 (1) | pavlefshme në rastet e mëposhtme:<br><br>a) nëse një autoritet ose ent kontraktor ka nënshkruar një kontratë pa publikuar paraprakisht shpalljen e njoftimit të kontratës, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji;<br><br>b) kur nuk janë zbatuar parashikimet e këtij ligji në lidhje me zbatimin e procedurave të ankimit, duke privuar personat e interesuar për të ushtruar të drejtën e tyre për ankim;<br><br>c) kur nuk janë zbatuar rregullat për rihapjen e garës, për | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | parakontraktuale kur kjo shkelje kombinohet me një shkelje të Direktivës 2014/24/BE ose Direktivës 2014/23/BE, nëse kjo shkelje ka prekur mundësitë e ofertuesit që aplikon për shqyrtim, që të fitojë kontratën;<br>(c) në rastet e përmendura në nënparagrafin e dytë të nenit 2b, germa c, të kësaj Direktive, kur shtetet anëtare kanë përdorur shmangien nga periudha e pezullimit për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër dhe në një sistem dinamik blerjeje. | | | kontratat e lidhura në bazë të një marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara dhe në sistemin dinamik të blerjeve të ndarë në kategori.<br>ç) kur kontrata është nënshkruar në kushtet e konfliktit të interesit.<br>d) nëse një autoritet ose ent kontraktor ka nënshkruar një kontratë, duke mosrespektuar vendimin e dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik. | | |
| | | | **3. VKM Nr. 486, datë 21.07.2022**<br>(2) | Autoritetet ose entet kontraktore duhet të veprojnë në përputhje me rregullat dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” (në vijim “LPP”), për publikimin e procedurave, shpalljen e fituesve, nënshkrimin e kontratave dhe zbatimin e tyre. | | |
| | | | (3) | Shkelja e parimeve dhe rregullave, të parashikuara në LPP dhe Vendimin nr. 285/2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (RrPP), veç masave administrative të parashikuara në to, mund të përbëjë shkak për shpalljen | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | (4)<br><br>(5) | absolutisht të pavlefshme të kontratës së lidhur nga autoriteti ose enti kontraktor.<br><br>Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjatë shqyrtimit të një ankese për pavlefshmërinë e kontratës konstaton ekzistencën e kushteve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 119 të LPP-së mund të shpallë një kontratë absolutisht të pavlefshme.<br><br>Me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik kur nuk vendos pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të kontratës, me anë të një vendimi të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | (6) | ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë zbatimin e kontratës, nëse pezullimi mund të cënojë çështjet thelbësore të interesit të përgjithshëm.<br><br>Nëse në përfundim të shqyrtimit të ankesës, konstatohet ekzistenca e të paktën një prej kushteve të përcaktuara në nenin 119 të LPP, Komisioni i Prokurimit Publik, ka të drejtë: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar;<br><br>b) të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj;<br><br>c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji | | |
| 2d (2) | Pasojat e shpalljes së pavlefshmërisë së një kontrate parashikohen nga legjislacioni i brendshëm.<br>Legjislacioni i brendshëm mund të parashikojë anulimin prapaveprues të të gjithë detyrimeve kontraktuale ose të kufizojë objektin e anulimit të atyre detyrimeve që sërish duhet të përmbushen. Në rastin e fundit, shtetet anëtare parashikojnë aplikimin e penaliteteve alternative, sipas kuptimit të nenit 2e, paragrafi 2. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>118 (3) | Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:<br>a) të deklarojë të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji<br>b) të shkurtojë kohëzgjatjen e kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj;<br>c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 119 (2) | dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme, si rezultat i shkeljes së këtij ligji.<br><br>Kontrata mund të mos shpallet e pavlefshme edhe nëse ajo është lidhur jo sipas parashikimeve të pikës 1, nëse Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të të gjithë aspekteve përkatëse, çmon se shpallja e pavlefshme e kësaj kontrate mund të cënojë çështjet thelbësore të interesit të përgjithshëm.<br><br>Interesat ekonomike të lidhura drejtpërdrejt | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 119 (3) | me kontratën në fjalë si, kostot për shkak të vonesave në zbatimin e kontratës, kostot për shkak të shpalljes së një procedure të re prokurimi, kostot për shkak të ndryshimit të operatorit ekonomik që do të zbatojë kontratën, si edhe kostot për shkak të detyrimeve ligjore si pasojë e pavlefshmërisë, nuk konsiderohen çështje thelbësore të interesit të përgjithshëm.<br><br>Në rastin e konstatimit të situatave të pikës 2 më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të aplikojë zbatimin e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 119 (4) | masave të tjera administrative, si:<br><br>a) dënimin me gjobë të autoritetit ose entit kontraktor, për shkeljet e konstatuara;<br><br>b) shkurtimin e afatit të zbatimit të kontratës për të minimizuar dëmin e shkaktuar.<br><br>Gjoba duhet të vendoset në raport me vlerën e kontratës së nënshkruar, por në çdo rast jo më shumë se 10% e kësaj vlere. Rregulla të posaçme për këtë proces, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. | | |
| | | | **3. VKM Nr. 486, datë 21.07.2022** | Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, në rastin | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | (8)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>(9) | kur nuk shpallet pavlefshmëria e kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, merr masat si vijon:<br><br>a) Urdhëron autoritetin ose entin kontraktor për shkurtimin e afatit të zbatimit të kontratës për të minimizuar dëmin e shkaktuar;<br><br>b) Vendos dënimin me gjobë të autoritetit ose entit kontraktor, për shkeljet e konstatuara sipas këtij vendimi.<br><br>Gjoba duhet të vendoset në raport me vlerën e kontratës së nënshkruar, por në cdo rast jo më shumë se 10 % të kësaj vlere. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | (10) | Në vendosjen e masës së gjobës, Komisioni i Prokurimit Publik duhet të marrë në konsideratë disa elementë, si:<br><br>- Rrethanat, në të cilat është kryer shkelja;<br>- Rëndësia e shkeljes së kryer;<br>- Pasojat, që kanë ardhur;<br>- Proporcionaliteti midis dëmit të shkaktuar dhe masës së gjobës;<br>- Vlerën e përllogaritur të kontratës;<br>- Parimet e prokurimit, që janë shkelur;<br>- Përsëritjen e shkeljeve në raste të tjera;<br>- Elemente të tjera objektive, që Komisioni i Prokurimit Publik i | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | (11) | evidenton dhe argumenton në vendimmarrjen e saj.<br><br>Komisioni i Prokurimit Publik përcakton në vendimin e tij, afatin brenda të cilit, duhet zbatuar vendimi i dhënë. | | |
| | | | **4. Projektligj**<br><br>(38) | Në nenin 119 "Pavlefshmëria e kontratave", në pikën 2, togfjalëshi "… *jo sipas parashikimeve"* zëvendësohet me togfjalëshin *"…sipas parashikimeve …".* | | |
| 2d (3) | Shtetet anëtare mund të parashikojnë që organi shqyrtues i pavarur nga autoriteti kontraktor nuk mund ta konsiderojë një kontratë të pavlefshme edhe pse ajo është dhënë në mënyrë të kundërligjshme sipas arsyeve të | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>119 (2) | Kontrata mund të mos shpallet e pavlefshme edhe nëse ajo është lidhur jo sipas parashikimeve të pikës 1, nëse Komisioni i Prokurimit Publik, | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përmendura në paragrafin 1, nëse organi shqyrtues, pasi ka ekzaminuar të gjitha aspektet përkatëse, zbulon se arsye madhore që lidhen me një interes të përgjithshëm kërkojnë që kontrata të mbetet në fuqi. Në këtë rast, shtetet anëtare parashikojnë penalitete alternative që do të aplikohen sipas kuptimit të nenit 2e, paragrafi 2.<br><br>Interesat ekonomikë për vlefshmërinë e kontratës mund të merren në konsideratë si arsye madhore, vetëm nëse pavlefshmëria në raste të veçanta do të çonte në pasoja joproporcionale.<br><br>Megjithatë, interesat ekonomikë që lidhen drejtpërsëdrejti me kontratën në fjalë nuk përbëjnë arsye madhore që lidhen me interesin e përgjithshëm. Interesat | | | pas shqyrtimit të të gjithë aspekteve përkatëse, çmon se shpallja e pavlefshme e kësaj kontrate mund të cënojë çështjet thelbësore të interesit të përgjithshëm.<br><br>Interesat ekonomike të lidhura drejtpërdrejt me kontratën në fjalë si, kostot për shkak të vonesave në zbatimin e kontratës, kostot për shkak të shpalljes së një procedure të re prokurimi, kostot për shkak të ndryshimit të operatorit ekonomik që do të zbatojë kontratën, si edhe kostot për shkak të detyrimeve | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ekonomikë që lidhen drejtpërsëdrejti me kontratën përfshijnë, ndër të tjera, kostot që shkaktohen nga vonesa në zbatimin e kontratës, kostot që shkaktohen nga nisja e një procedure të re prokurimi, kostot që shkaktohen nga ndryshimi i operatorit ekonomik që zbaton kontratën dhe kostot e detyrimeve ligjore që shkaktohen nga pavlefshmëria. | | 119 (3) | ligjore si pasojë e pavlefshmërisë, nuk konsiderohen çështje thelbësore të interesit të përgjithshëm.<br><br>Në rastin e konstatimit të situatave të pikës 2 më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të aplikojë zbatimin e masave të tjera administrative, si:<br><br>a) dënimin me gjobë të autoritetit ose entit kontraktor, për shkeljet e konstatuara;<br><br>b) shkurtimin e afatit të zbatimit të kontratës për të minimizuar dëmin e shkaktuar.<br><br>Gjoba duhet të vendoset në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 119 (4) | raport me vlerën e kontratës së nënshkruar, por në çdo rast jo më shumë se 10% e kësaj vlere. Rregulla të posaçme për këtë proces, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. | | |
| | | | **3. VKM Nr. 486, datë 21.07.2022** (7) | Nëse pas shqyrtimit të të gjithë aspekteve përkatëse, çmohet se shpallja e pavlefshmërisë absolute të kontratës mund të cënojë çështjet thelbësore të interesit të përgjithshëm, Komisioni i Prokurimit Publik, mund të vendosë të mos e shpallë kontratën | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | absolutisht të pavlefshme, pavarësisht ekzistencës së kushteve të nenit 119/1 të LPP.<br><br>Nuk konsiderohen çështje thelbësore të interesit të përgjithshëm interesat ekonomike të lidhura drejtpërdrejtë me kontratën në fjalë:<br><br>i. kostot për shkak të vonesave në zbatimin e kontratës;<br><br>ii. kostot për shkak të shpalljes së një procedure të re prokurimi; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | iii. kostot për shkak të ndryshimit të operatorit ekonomik që do të zbatojë kontratën;<br>iv. kostot për shkak të detyrimeve ligjore si pasojë e pavlefshmërisë. | | |
| | | | **4. Projektligj**<br>(38) | Në nenin 119 "Pavlefshmëria e kontratave", në pikën 2, togfjalëshi "… *jo sipas parashikimeve"* zëvendësohet me togfjalëshin *"...sipas parashikimeve ...".* | | |
| 2d (4) | Shtetet anëtare parashikojnë që paragrafi 1, germa a, e këtij neni të mos zbatohet kur:<br>— autoriteti kontraktor konsideron se | | | | E plotë | Kreu XIV i ligjit parashikon qartesisht rastet se kur kontrata shpallet e pavlefshme. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhënia e një kontrate pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian është e lejueshme në përputhje me Direktivën 2014/25/BE ose Direktivën 2014/23/BE;<br>— autoriteti kontraktor ka shpallur në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian një njoftim, sipas përshkrimit në nenin 3, germa a, të kësaj direktive, ku shpreh qëllimin e tij për të lidhur kontratën; dhe<br>— kontrata nuk është lidhur përpara përfundimit të një periudhe prej të paktën 10 ditësh kalendarike, duke filluar nga e nesërmja e datës së shpalljes së këtij njoftimi. | | | | | Ndërkohë, VKM shërben si plotësuese e ligjit duke percaktuar detaje mbi procesin e shpalljes se pavlefshmerise. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2d (5) | Shtetet anëtare parashikojnë që paragrafi 1, germa c, e këtij neni të mos zbatohen kur:<br>— autoriteti kontraktor konsideron se dhënia e kontratës është në përputhje me nenin 52, paragrafi 6, të Direktivës 2014/25/BE,<br>— autoriteti kontraktor u ka dërguar ofertuesve të interesuar vendimin për dhënien e kontratës së bashku me një përmbledhje të arsyeve të përmendura në ndarjen e parë të nënparagrafit 4, të nenit 2a, paragrafi 2, të kësaj direktive; dhe<br>— kontrata nuk është lidhur përpara përfundimit të një periudhe prej të paktën 10 ditësh kalendarike, duke filluar nga e nesërmja e datës në të cilën vendimi për dhënien e kontratës i dërgohet | | | | E plotë | Kreu XIV i ligjit parashikon qartesisht rastet se kur kontrata shpallet e pavlefshme.<br><br>Ndërkohë, VKM shërben si plotësuese e ligjit duke percaktuar detaje mbi procesin e shpalljes se pavlefshmerise. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ofertuesve të interesuar, nëse përdoret faksi ose mjetet elektronike; ose nëse përdoren mjete të tjera komunikimi, përpara përfundimit të një periudhe prej të paktën 15 ditë kalendarike, duke filluar nga e nesërmja e datës në të cilën vendimi për dhënien e kontratës i dërgohet ofertuesve të interesuar, ose të paktën 10 ditë kalendarike, duke filluar nga e nesërmja e datës së marrjes në dorëzim të vendimit për dhënien e kontratës. | | | | | |
| Shkeljet e kësaj direktive dhe penalitetet alternative<br>2e (1) | Në rast shkeljeje të nenit 1, paragrafi 5; nenit 2, paragrafi 3; ose nenit 2a, paragrafi 2, që nuk mbulohet nga neni 2d, paragrafi 1, germa b, shtetet anëtare parashikojnë pavlefshmërinë në përputhje me nenin 2d, paragrafi 1 deri në 3, ose | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br><br>Pavlefshmëria e kontratës<br>119 (3) | Në rastin e konstatimit të situatave të pikës 2 më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të aplikojë zbatimin e masave të tjera administrative, si:<br><br>a) dënimin me | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | penalitete alternative. Shtetet anëtare mund të parashikojnë që organi shqyrtues i pavarur nga autoriteti kontraktor, pasi ka shqyrtuar të gjithë aspektet përkatëse, vendos nëse kontrata duhet të konsiderohet e pavlefshme ose nëse duhet të vendosen penalitete alternative. | | 119 (4) | gjobë të autoritetit ose entit kontraktor, për shkeljet e konstatuara;<br><br>b) shkurtimin e afatit të zbatimit të kontratës për të minimizuar dëmin e shkaktuar.<br><br>Gjoba duhet të vendoset në raport me vlerën e kontratës së nënshkruar, por në çdo rast jo më shumë se 10% e kësaj vlere. Rregulla të posaçme për këtë proces, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2e (2) | Penalitetet alternative duhet të jenë efikase, proporcionale dhe shtrënguese. Penalitetet alternative janë:<br>– vendosja e gjobave për autoritetin kontraktor; ose<br>– shkurtimi i kohëzgjatjes së kontratës.<br>Shtetet anëtare mund t'i japin organit shqyrtues kompetencë për ta gjykuar vetë marrjen në konsideratë të të gjithë faktorëve përkatës, duke përfshirë seriozitetin e shkeljes, sjelljen e autoritetit kontraktor dhe, në rastet e përmendura në nenin 2d, paragrafi 2, shkallën deri në të cilën kontrata mbetet në fuqi.<br>Kompensimi i dëmeve nuk përbën një penalitet të përshtatshëm për qëllimet e këtij paragrafi. | | 119 (3)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>119 (4) | Në rastin e konstatimit të situatave të pikës 2 më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të aplikojë zbatimin e masave të tjera administrative, si:<br>a) dënimin me gjobë të autoritetit ose entit kontraktor, për shkeljet e konstatuara;<br>b) shkurtimin e afatit të zbatimit të kontratës për të minimizuar dëmin e shkaktuar.<br>Gjoba duhet të vendoset në raport me vlerën e kontratës së nënshkruar, por në çdo rast jo më shumë se 10% e kësaj vlere. Rregulla të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | posaçme për këtë proces, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. | | |
| Afatet kohore 2f (1) | Shtetet anëtare mund të parashikojnë se aplikimi për shqyrtim, në përputhje me nenin 2d, paragrafi 1, duhet të bëhet:<br><br>a. përpara përfundimit të të paktën 30 ditëve kalendarike, duke filluar nga e nesërmja e datës në të cilën:<br><br>— autoriteti kontraktor ka shpallur njoftimin për dhënien e kontratës, në përputhje me nenet 70 dhe 71 të Direktivës 2014/25/BE ose nenet 31 dhe 32 të Direktivës 2014/23/BE, nëse ky njoftim përfshin justifikimin e vendimit të autoritetit kontraktor për të dhënë kontratën pa shpallje | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Afatet për ankim 110 (1) | Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentat e tenderit.<br><br>Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë | E plotë | Pavarësisht se transpozimi është i plotë duhet theksuar se Direktivat e Ankesave janë parimore dhe nuk kërkojnë transpozim të drejtpërdrejtë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | paraprake të njoftimit të kontratës në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, ose<br><br>— autoriteti kontraktor ka informuar ofertuesit dhe kandidatët e interesuar për lidhjen e kontratës, nëse ky informacion përmban një përmbledhje të arsyeve përkatëse, siç parashtrohet në nenin 75, paragrafi 2, të Direktivës 2014/24/BE ose, në zbatim të dispozitave të nenit 75, paragrafi 3, të asaj direktive ose në nën paragrafin e nenit 40 (1) të Direktivës 2014/23/BE, në zbatim të dispozitave të nenit 40, paragrafi 2, të asaj direktive. Kjo zgjidhje zbatohet edhe për rastet e përmendura në nenin 2b, germa c, të kësaj direktive; | | 110 (2) | monetar, ky afat është 7 ditë.<br><br>Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anullimit.<br><br>Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, ky afat është 7 ditë.<br><br>Në procedurat e prokurimit me faza, mbi kufirin e lartë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (b) dhe për çdo rast, përpara përfundimit të një periudhe prej të paktën gjashtë muajsh, duke filluar nga e nesërmja e datës së lidhjes së kontratës. | | 110 (3)<br><br>110 (4) | monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim.<br><br>Në procedurat e prokurimit me faza, nën kufirin e lartë monetar, ky afat është 7 ditë.<br><br>Në rastin e procedurave për rihapjen konkurimit për lidhjen e një kontrate në bazë të një marrëveshjeje kuadër, me disa operatorë ekonomikë, me | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 110 (5) | procedurë prokurimi mbi kufirin e lartë monetar, afati për paraqitjen e ankesave është 10 ditë nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës.<br><br>Në rastin e kontratave të lidhura në bazë të një marrëveshjeje kuadër me vlerë nën kufirin e lartë monetar, ky afat është 7 ditë.<br><br>Në rastin e procedurave me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | brenda 30 ditëve nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit.<br><br>Nëse është publikuar njoftimi vullnetar për transparencë, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, sa i takon plotësimit të kushteve për përdorimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe përmbajtjes së dokumentave të tenderit.<br><br>Në rastin e konstatimit të një kontrate publike të lidhur pa zhvilluar | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 110 (6) | ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në këtë ligj, dhe/ose në rastin kur nuk është publikuar njoftimi i fituesit ose njoftimi i kontratës së nënshkruar, afati për paraqitjen e një ankese lidhur me këtë kontratë është 60 ditë nga dita e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës | | |
| | | | **2. VKM nr. 285, datë 19.05.2021**<br><br>Afatet per paraqitjen e ankesave<br>98 (1) | Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:<br>c) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentat e tenderit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;<br>d) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentat e tenderit në procedurat | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 98 (2) | e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.<br><br>Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:<br>c) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anullimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 98 (3) | d) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anullimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.<br><br>Në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, në procedurat e prokurimit me faza, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/ entit kontraktor:<br>c) brenda 10 (dhjetë) | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 98 (4) | ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;<br>d) brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.<br><br>Në rastin e ankesave për lidhjen e një kontrate në bazë të një marrëveshjeje kuadër, me disa operatorë ekonomikë, pas | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Afate për ankime të veçanta 99 (1) | procedurave për rihapjen e konkurimit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:<br>c) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;<br>d) brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës, në procedurat | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 99 (2) | e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.<br><br>Në rastin e procedurave me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit. Nëse është publikuar njoftimi vullnetar për transparencë, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, sa i takon | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | plotësimit të kushteve për përdorimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe përmbajtjes së dokumentave të tenderit.<br><br>Në rastin e konstatimit të një kontrate publike të lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në këtë ligj dhe/ose në rastin kur nuk është publikuar njoftimi i fituesit ose njoftimi i kontratës së nënshkruar, afati për paraqitjen e një ankese lidhur me këtë kontratë është 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga dita e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2f (2) | Në të gjitha rastet e tjera, përfshij aplikimin për shqyrtim në përputhje me nenin 2e, paragrafi 1, afatet kohore për të aplikuar për shqyrtim do të përcaktohen nga legjislacioni i brendshëm, sipas dispozitave të nenit 2c."; | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Ankesat për prokurimet me vlerë të vogël<br>116 (1) | Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, operatorët ekonomikë kanë të drejtën të ankohen vetëm në autoritetin ose entin kontraktor, brenda 2 ditëve nga shpallja e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik. | E plotë | Parashikime mbi pavlefshmerine e kontratave dhe pasojat e saj jane perfshire edhe ne Kodin Civil i cili zbatohet edhe ne rastin e kontratave publike |
| Përmbajtja e njoftimit vullnetar ex ante për transparencën 3a | Njoftimi i përmendur në ndarjen e dytë të nenit 2d, paragrafi 4, formati i të cilit miratohet nga Komisioni, në përputhje me procedurën këshillimore, të përmendur në nenin 3b, paragrafi 2, përmban informacionin e mëposhtëm:<br>a. emrin dhe të dhënat e kontaktit të autoritetit kontraktor;<br>b. një përshkrim të objektit të kontratës;<br>c. një justifikim të vendimit të autoritetit kontraktor për të dhënë kontratën pa shpallje | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Llojet e njoftimeve<br>55 | Njoftimet që përdoren në procedurat e prokurimit publik janë si më poshtë:<br><br>e) Njoftimi vullnetar i transparencës për procedurën me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;<br><br>Në rastin e procedurave me | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | paraprake të njoftimit të kontratës në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian;<br>d. emrin dhe të dhënat e kontaktit të operatorit ekonomik, i cili është shpallur fitues i kontratës; dhe<br>e. kur është e përshtatshme, çdo informacion tjetër që konsiderohet i dobishëm nga autoriteti kontraktor. | | Afatet për ankim<br>110 (5) | negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 30 ditëve nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit.<br><br>Nëse është publikuar njoftimi vullnetar për transparencë, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, sa i takon plotësimit të kushteve për përdorimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe përmbajtjes së | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dokumentave të tenderit. | | |
| | | | **2. VKM nr. 285, datë 19.05.2021**<br><br>Njoftimi vullnetar i transparencës për procedurën me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës<br>23 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br>23 (2) | Pavarësisht se publikimi i njoftimit të kontratës, nuk është i detyrueshëm në rastin e procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, mund të vendosë të publikojë një njoftim për të rritur transparencën dhe konkurues mërinë në procedurë.<br><br>Ky njoftim publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike.<br><br>Në këtë rast, autoriteti ose enti kontraktor | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 23 (3) | publikon njoftimin e kontratës, me të njëjtën përmbajtje sipas përcaktimit në nenin 20 të këtyre rregullave, si dhe dokumentet përkatëse të tenderit. | | |
| Procedura e Komitetit<br>3b (1) | Komisioni do të mbështetet nga Komiteti Këshillimor për Kontratat Publike, i ngritur sipas nenit 1 të Vendimit të Këshillit 71/306/KEE, datë 26 korriku 1971 (në vijim i referuar si Komiteti). | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet veprimtarise se institucioneve te BE |
| 3b (2) | Në lidhje me këtë paragraf zbatohen nenet 3 dhe 7, të Vendimit të Këshillit 1999/468/KE të datës 28 qershor 1999, që parashtrojnë procedurat për ushtrimin e kompetencave zbatuese që i delegohen Komisionit duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të saj. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet veprimtarise se institucioneve te BE |
| Mekanizmi korrigjues<br>8 (1) | Komisioni mund të përdorë procedurën e parashikuar | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet Komisionit Europian |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | në paragrafin 2 deri në paragrafin 5 kur; përpara lidhjes së një kontrate, ai gjykon se gjatë procedurës së prokurimit, që është brenda objektit të Direktivës 2014/25/BE ose Direktivës 2014/23/BE, ose ne lidhje me nenin 26(1) te Direktivës 2014/25/BE është kryer një shkelje e rëndë e së drejtës komunitare në fushën e prokurimit publik. | | | | | |
| 8 (2) | Komisioni njofton shtetet anëtare përkatëse për arsyet që e kanë çuar atë në përfundimin se është kryer një shkelje e rëndë dhe kërkon korrigjimin e saj nëpërmjet mjeteve të përshtatshme. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet Komisionit Europian |
| 8 (3) | Brenda 21 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit të përmendur në paragrafin 2, shteti anëtar përkatës i komunikon Komisionit: | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | a. konfirmimin e tij se shkelja është korrigjuar;<br>b. një raport me arsyet përse nuk është bërë asnjë korrigjim; ose<br>c. një njoftim ku sqarohet se procedura e prokurimit është pezulluar ose nga autoriteti kontraktor me iniciativën e tij, ose mbi bazën e kompetencave të specifikuara në nenin 2, paragrafi 1, germa a. | | | | | |
| 8 (4) | Raporti i arsyetuar i komunikuar sipas paragrafit 3, germa b, mund të mbështetet, ndër të tjera, mbi faktin se shkelja e pretenduar është tashmë objekt i procedurave të shqyrtimit gjyqësor ose i procedurave të tjera të shqyrtimit, të përmendura në nenin 2, paragrafi 9. Në këtë rast, shteti anëtar i njofton Komisionit rezultatin e këtyre | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare dhe Komisionit Europian |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | procedurave ligjore, sapo ky rezultat të bëhet i ditur. | | | | | |
| 8 (5) | Kur jepet njoftimi se procedura e prokurimit është pezulluar në përputhje me paragrafin 3, germa c, shteti anëtar njofton Komisionin kur hiqet ky pezullim ose kur fillohet procedura për një kontratë tjetër, e cila lidhet plotësisht ose pjesërisht me çështjen në fjalë. Ky njoftim duhet të konfirmojë se shkelja e pretenduar është korrigjuar ose duhet të përfshijë një raport të arsyetuar se përse nuk është bërë asnjë korrigjim. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare dhe Komisionit Europian |
| Zbatimi 12 (1) | Komisioni në konsultim me Komitetin, mund t'u kërkojë shteteve anëtare, që t'i dorëzojnë informacione për funksionimin e procedurave të brendshme të shqyrtimit. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet veprimtarise se institucioneve te BE |
| 12 (2) | Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare te BE |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | çdo vit tekstin e të gjitha vendimeve, së bashku me arsyet përkatëse, të marra nga organet e tyre shqyrtuese, në përputhje me nenin 2d, paragrafi 3. | | | | | |
| Shqyrtimi 12a | Jo më vonë se data 20 dhjetor 2012, Komisioni shqyrton zbatimin e kësaj direktive dhe i raporton Parlamentit Evropian dhe Këshillit për efikasitetin e saj dhe në veçanti për efikasitetin e penaliteteve alternative dhe afateve kohore". | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet veprimtarise se institucioneve te BE |
| 13 (1) | Shtetet Anëtare do ti hyjnë në fuqi, përpara datës 1 Janar 1993, masat e nevojshme për t'u pajtuar me këtë Direktivë. Mbretëria e Spanjës do marri këto masa jo më vonë se 30 qershor 1995. Republika Helenike dhe Republika Portugeze do t'i marrë këto masa jo më vonë se 30 Qershor 1997. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare te BE |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ata do t'i komunikojnë Komisionit mbi keto.<br>Kur Shtetet Anëtare miratojnë këto masa, ato do të përmbajnë një<br>referencë në këtë Direktivë ose shoqërohet nga një referencë e tillë me rastin e botimit të tyre zyrtar. Metodat e bërjes një referencë e tillë do të përcaktohet nga Shtetet Anëtare. | | | | | |
| 13 (2) | Shtetet Anëtare do të sjellin në fuqi masat e përmendura në paragrafin 1 në të njëjtat data me ato (të përcaktuara në Direktivën 90/531/ KEE). | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare te BE |
| 13 (3) | Shtetet Anëtare do t'i komunikojnë Komisionit tekstet e dispozitave kryesore të së drejtës së brendshme të cilat ato i adoptojnë në fushën qeverisur nga kjo direktivë. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare te BE |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | Kjo Direktivë u adresohet Shteteve Anëtare. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare te BE |